

VENDIM
Nr. 390, datë 28.5.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I SUPERSTRADËS TIRANË–DURRËS (LOTI 1) – FAZA I DHE FAZA II”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i superstradës Tiranë–Durrës (loti 1) – faza I dhe faza II”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 25 136 045.80 (njëzet e pesë milionë e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e pesë pikë tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 136 045.80 (njëzet e pesë milionë e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e pesë pikë tetëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim për pasuritë, pronë private, që miratohen me anë të këtij vendimi, do të verifikohen kufizimet hipotekare dhe likuidimi i pronarëve të shpronësuar do të bëhet pasi të vlerësohet dokumentacioni përkatës ligjor, lidhur me përmbushjen e detyrimeve financiare nga institucionet bankare.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi

administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “ZGJERIMI I SUPERSTRADËS TIRANE DURRËS (LOTI 1) – FAZA 1 DHE FAZA 2”

PRONARI				TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËSË SË PASURISË)		VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM								SHËNIM E (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	TË DHËNAT E PASURISË		TOKË TRUALL				NDËRTESË SOCIAL- EKONOMIKE		VLERA TOTALE (LEKË)		
				ZK	Numri i pasurisë	Lloji ipasarisë	Sip. Totale (m ²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. totale (m ²)		Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	
1	Shoqëria "Alumil-Albania" sh.p.k.	2119	148/20	Truall	25.948.00	1822	4.242.00	7.728.924.00				7.728.924.00		
2	G.P.A.	2119	148/44	Truall	3.400.00	506.3	4.242.00	2.147.724.60	906.00	456.00	7.294.193.80	9.441.918.40		
3	Mirela Ismail Papuli	2119	257/7	Truall	3.203.00	414.4	4.242.00	1.757.884.80				1.757.884.80		
4	Mirela Ismail Papuli	2119	257/10	Truall	3.182.00	776.9	4.242.00	3.295.609.80				3.295.609.80		
5	Shoqëria "Eurobeton 2005" sh.p.k.	2119	257/3	Truall	11.665.00	686.4	4.242.00	2.911.708.80				2.911.708.80		
VLERA TOTALE												25.136.045.80		